



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 26, datë 25/07/2025

“PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 % NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN Qershor 2025”

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, I ndryshuar; Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; Ligjit 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” indryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68, dt.23.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2025”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.2 dt.24.01.2025 “Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor”, si dhe referuar relacionit përmbledhës, Drejtoria e Shërbimit Social me propozim të kryetarit të Bashkisë, i paraqeti Këshillit Bashkiak dhe:

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike për muajin **Qershor 2025**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr. Familjeve 9, fondi 40.448 lekë.**
2. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga buxheti i Bashkisë Kavajë, për muajin **Qershor 2025**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr. familjeve 92, fondi 332.766 lekë.**
3. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë, llogaria “Transferte në buxhetet familjare”.